

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më /08/2026

LËNDA: PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS – MALLRA MBI KUFIRIN E
LARTË MONETAR

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE

I mbajtur sot në datë 21.08.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, Z. Aleksandër Pjetri, persona përgjegjës të emëruar sipas Urdhërit të Prokurimit Nr. 787/3 Prot, datë 21.08.2026 për procedurën e prokurimit me objekt: “Çela 20 kV për N.Stacione”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Pajisje elektrike 31681000-3.

Vlera e fondit limit: 159.850.000 (Njëqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë lekë) Lekë pa TVSH, In Eur: - 1,721,604.39 EUR (një milion e shtatëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e katër euro e tridhjetë e nëntë cent) Euro Without VAT vënë në dispozicion nga të ardhurat e OSSH sh.a zëri i investimev 2026. Kursi kembimit sipas Bankës së Shqiperisë i datës 28.05.2026 është 21.08.2026 është 92.87 (nëntëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e shtatë)

Afati i lëvrim: 8 (tetë) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Baza ligjore për zhvillimin e kësaj procedure

Zhvillimi i kësaj procedure të prokurimit mbështetet në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, si më poshtë:

- Neni 33, pika 1, shkronja “a”, e Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili përcakton se autoritetet kontraktore përdorin procedurën e hapur për blerjen e mallrave, shërbimeve ose punëve mbi kufirin e lartë monetar.
- Neni 40 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili rregullon mënyrën e zhvillimit të procedurave të hapura mbi kufirin e lartë monetar për mallra, duke garantuar transparencë, konkurrencë dhe zbatim të drejtë të parimeve të ligjit.
- Neni 3 i Ligjit nr. 162/2020, që përcakton parimet bazë të prokurimit publik, si transparenca, trajtimi i barabartë i operatorëve ekonomikë, mosdiskriminimi dhe përdorimi efikas i fondeve publike.

Për argumentimin e fondit limit grupi i punës i caktuar me urdher të titullarit të Ak-se, j’u referuan studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
 - b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
 - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
 - ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.
- Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Referuar nenit 39 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka analizuar mundësinë e ndarjes në lote të procedurës së prokurimit me objekt **“Çela 20 kV për N/Stacione”** dhe, bazuar në natyrën e objektit, karakteristikat teknike dhe nevojën për realizimin e një furnizimi të unifikuar dhe të koordinuar, vlerëson se ndarja e procedurës në lote nuk është e përshtatshme.

Çelat 20 kV që përbëjnë objektin e kësaj procedure janë pajisje elektrike të specializuara, të cilat do të instalohen në N/Stacione dhe do të jenë pjesë përbërëse e sistemeve të tensionit të mesëm. Furnizimi i tyre kërkon **përputhshmëri të plotë teknike, funksionale dhe elektrike** ndërmjet të gjitha pajisjeve, si dhe integrim me instalimet, sistemet e mbrojtjes, komandimit, kontrollit dhe automatizimit të N/Stacioneve.

Ndarja e furnizimit në lote të veçanta dhe realizimi i tij nga operatorë ekonomikë të ndryshëm mund të krijojë vështirësi në garantimin e njëtrajtshmërisë së specifikimeve teknike, kompatibilitetit ndërmjet pajisjeve dhe koordinimit të tyre gjatë instalimit, testimit dhe vënies në funksion.

Gjithashtu, në rast të një defekti ose problematike gjatë instalimit, testimit apo funksionimit të çelave 20 kV, ndarja e furnizimit në lote të ndryshme mund të krijojë vështirësi në **identifikimin e shkakut të problematikës dhe përcaktimin e përgjegjësisë kontraktore,**

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

veçanërisht kur pajisjet e furnizuara duhet të funksionojnë së bashku si pjesë e një sistemi të integruar elektrik.

Realizimi i furnizimit nëpërmjet një procedure dhe kontrate të vetme krijon mundësinë për **koordinim të unifikuar teknik**, standardizim të pajisjeve dhe karakteristikave të tyre, si dhe një përgjegjësi të qartë të kontraktorit për përputhshmërinë, furnizimin, testimin dhe dokumentacionin teknik të pajisjeve.

Ndarja në lote mund të sjellë gjithashtu varësi ndërmjet afateve të furnizimit dhe kontratave të ndryshme, duke rritur riskun e vonesave në kompletimin e pajisjeve të nevojshme për realizimin dhe vënien në funksion të N/Stacioneve.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se, duke marrë në konsideratë **natyrën e specializuar të çelave 20 kV, nevojën për standardizim dhe përputhshmëri teknike të pajisjeve, integrimin e tyre me sistemet ekzistuese të N/Stacioneve, nevojën për koordinim të unifikuar gjatë furnizimit, instalimit, testimit dhe vënies në funksion, si dhe qartësinë e përgjegjësisë kontraktore**, procedura e prokurimit është e përshtatshme të zhvillohet pa u ndarë në lote.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor argumenton dhe justifikon **mosndarjen në lote të procedurës së prokurimit**, duke vlerësuar se kjo mënyrë organizimi siguron realizimin më të koordinuar dhe më efektiv të objektit të prokurimit, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Në këto kushte, mosndarja në lote është e arsyetuar dhe në përputhje me nenin 39 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “*Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik. Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim si dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024,2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2026), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2026 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

AFTËSITË TEKNIKE DHE PROFESIONALE:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi 2.3.1. Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt objekt kontrate, në të cilën duhet të deklarojnë emërtesën e artikullit dhe të dhënat e kërkuara, sipas tabelës së mëposhtme dhe që plotësojnë kërkesat sipas skedes teknike të ofruar nga ata.

Tabelat e të dhënave teknike të pajisjeve të kërkuara dhe ato të ofruar nga operatorët ekonomik.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania Prodhuese e artikullit të ofruar	Referenca për specifikimet teknike sipas katalogëve të artikullit të ofruar
1.	Çela të kompletuara 20kV		
2.	Sistem diagnostikim analizim i gazrave ne vajin e transformatorit te fuqise		

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi i deklaruar i pajisjeve që ofrojnë (sipas deklarimit në skedën teknike) ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesi për realizimin e furnizimeve me artikujt objekt kontrate.

Nëse do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar nga prodhuesit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Autorizimi në çdo rast duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e skedës teknike dhe autorizimit të prodhuesit / distributorëve të autorizuar nga prodhuesit është një kërkesë me rëndësi, pasi së pari identifikon artikujt, tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi e bazon ofertën e tij mbi produkte reale dhe është i autorizuar për ofrimin e tyre tek AK. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik të prodhuesit për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi, përfshirë edhe skedën teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike për pajisjet e mesiperme. *Në katalog, të markohen në menyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.5 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dëshmi të Test Raporteve për materialet/pajisjet e ofruara sipas listës në tabelen e mesiperme të kërkesave teknike (nr 2.3.2), të vlefshme të lëshuara nga prodhuesi, nga institucione të autorizuar ose ekuivalente të tyre. Këto dokumente duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të ofruara me kërkesat në skeden teknike dhe standardet e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues të paraqesë pajisje dhe materiale , të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Duke marrë parasysh që lista e kërkuar përbehet nga pajisje të rëndësishme që përdoren në N/stacione elektrike, kërkohej nga prodhuesi që të dëshmojë se është prodhues i certifikuar nga institucione ndërkombëtare sipas standarteve IEC/EN/SSH dhe pajisjet e kërkuara kryejnë testime standarte të certifikuar nga prodhuesi, institucione të autorizuar ose ekuivalentet e tyre në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Kërkesa që operatorët ekonomikë ofertues të paraqesin dëshmi të test raporteve për materialet dhe pajisjet e ofruara është e nevojshme për të verifikuar përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatueshme, si dhe me kërkesat funksionale të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Duke qenë se objekti i kontratës përfshin furnizimin të pajisjeve të rëndësishme që do të përdoren në N.Stacione elektrike, të cilat janë pjesë e rrjetit elektroenergjetik shqiptar, është e domosdoshme që pajisjet e ofruara të kenë kaluar testimet përkatëse dhe të provohet se plotësojnë kërkesat e sigurisë, performancës, besueshmërisë dhe jetëgjatësisë.

Dëshmitë e testimeve, të lëshuara nga prodhuesi, nga institucione të autorizuar ose ekuivalente të tyre, shërbejnë si provë objektive se materialet dhe pajisjet janë testuar sipas standardeve teknike përkatëse dhe se rezultatet e tyre janë në përputhje me parametrat e kërkuar. Kjo i mundëson autoritetit kontraktor të verifikojë, në fazën e vlerësimit të ofertave, se produktet e ofruara janë të përshtatshme për përdorim në rrjetin elektroenergjetik dhe se nuk krijojnë rrezik për sigurinë, funksionimin dhe vazhdimësinë e furnizimit me energji elektrike.

Kjo kërkesë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi nuk e kufizon burimin e dokumentacionit vetëm tek prodhuesi, por lejon edhe dokumente të lëshuara nga institucione të pavarura të autorizuar për keto testime ose ekuivalente të tyre, duke garantuar njëkohësisht

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

konkurrencën dhe verifikimin objektive të cilësisë dhe konformitetit të materialeve dhe pajisjeve të ofruara.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN UNI ISO 9001-2015 e perditesuar (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo certifikate kërket ne momentin e levrimit të mallit nga operatori ekonomik fitues dhe shoqëron mallin që instalohet në objekt. Kurse në momentin e ofertimit, AK pranon mundësinë të një vetëdeklarimi nga OE ofertues që në këtë rast, furnizuesi është konform standardeve të cilësisë dhe rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.6 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te paraqese deklarate konformiteti ku te shprehet qe materialet te kene markim CE/SSH IEC SSH EN /ose ekuivalentet e tyre.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në zbatim të: Nenit 77, pika 1, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i cili përcakton se autoriteti kontraktor duhet të përshkruajë me saktësi objektin e kontratës dhe karakteristikat teknike të mallrave që prokurohen, duke përdorur standarde dhe referenca objektive që sigurojnë konkurrencë të ndershme dhe vlerësim transparent të ofertave;

Neni 40, pika 6, gërma (c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku sanksionohet se autoritetet kontraktore kanë të drejtë të kërkojnë që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentacion mbështetës që provon përputhshmërinë teknike të mallrave të ofruara me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, përfshirë certifikata të lëshuara nga institucione të njohura apo deklarata konformiteti.

Kërkesa për paraqitjen e deklaratës së konformitetit ka për qëllim të garantojë se materialet e ofruara janë të certifikuara dhe në përputhje me standardet e sigurisë dhe cilësisë të njohura ndërkombëtarisht. Markimi **CE**, **SSH**, **IEC**, **EN** (ose ekuivalentët e tyre) vërteton se produktet janë prodhuar sipas kërkesave teknike dhe standardeve të aplikueshme, duke siguruar cilësi, siguri dhe ndërrveprueshmëri me pajisje të tjera në përdorim.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te plotesoje saktësisht kolonen e emertuar “Të dhëna teknike të ofruara nga ofertuesi” ne te gjitha tabelat e paraqitura ne shtojcen (Specifikimet teknike) te ketyre DT-ve.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

2.3.9 Operatorët ekonomikë ofertues duhet duhet të vërtetojnë se *kanë të punësuar në stafin e tyre ose të kontraktuar me kontratë shërbimi 1* (një) Inxhinier të certifikuar nga prodhuesi, distributori i autorizuar i tij ose ekuivalentet e tyre për instalimin dhe komisionimin e sistemit te diagnostikimit dhe analizimit te gazrave ne vajin e transformatoreve te fuqise.

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues në rastin se e ka pjesë të stafit inxhinierin e kërkuar, duhet te paraqesë:

- ✓ Kontrata e punës
- ✓ Liste pagesat. E-Sig
- ✓ Certifikata përkatëse te Inxhinierit të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve ose Distributori i autorizuar i tyre ose ekuivalentet e tyre.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në rast se disponon kontartë shërbimi operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- ✓ Kontratën e shërbimit
- ✓ Certifikata përkatëse të Inxhinierit të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve ose Distributori i autorizuar i tyre ose ekuivalentet e tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH SH.A, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një 1 (një) inxhinier elektrik të certifikuar nga prodhuesi ose distributor i tij i autorizuar për sistem DGA duke qenë se diagnostikojnë, analizojnë dhe monitorojnë pajisjen me të rëndësishme dhe me të shtrenjta të N.Stacioni elektrike transformatorin e fuqisë.

Sistemi DGA analizon gazrat e tretur dhe matjen e lagështisë në vajin e transformatoreve të fuqisë, dhe njihet si një test i rëndësishëm për vlerësimin real të gjendjes së transformatorëve fuqisë, me izolacion të peshtjellave në vaj, si janë edhe transformatorët në N.Stacionet elektrike të Shpërndarjes.

Ky sistem duhet të jetë i aftë për të integruar me sistemin qendror të monitorimit, në OSSH qendrore në mënyrë që të sinjalizojë gjendjen reale të transformatorit.

Me anë të këtij sistemi kryhen analizimi i gjendjes reale të vajit të transformatoreve të fuqisë, duke matur gazrat që janë ciluar në të si dhe lagështinë në të, duke shtuar informacionet mbi gjendjen reale të transformatorit të fuqisë.

Për sa me sipër qëllimi i këtij furnizimi dhe përfitimet e këtij sistemi DGA që analizon gazrat e tretur dhe matjen e lagështisë në vajin e transformatorit të fuqisë janë:

- koha e shpejtë e analizimit dhe vlerësimit të gjendjes reale të pajisjeve kryesore të fuqisë në N.Stacionet elektrike të Shpërndarjes.
- vlerësim të gjendjes reale të transformatorit të fuqisë, pajisja me të rëndësishme dhe me të shtrenjta nga ana ekonomike në N.Stacione.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Prandaj, kërkesa për inxhinier elektrik të certifikuar nuk lidhet me një kontratë pune, por është një kërkesë teknike për të garantuar që furnizimi të shoqërohet me asistencën profesionale të nevojshme për vënien në punë dhe konfigurimin e saktë të pajisjes për nevoja operacionale të autoritetit kontraktor.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku deklaron se të gjithë produktet janë të rinj (të përdorur).

Argumentim: Kjo kërkesë është vendosur në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë, si dhe me dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, pasi i shërben verifikimit të aftësisë së operatorëve ekonomikë për të ofruar pajisje që përmbushin plotësisht kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e interesit publik dhe përdorimin efektiv të fondeve publike.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMIVE TEKNIKE

Në dokumentacionin Teknik për realizimin e këtij projekti janë bashkëlidhur dokumentet me emërtimin “**Relacioni teknik Çela 20kV per N.Stacione**” nga Kapitulli 9, fq. 23, deri në fund janë paraqitur specifikimet teknike të detajuara për pajisjet që janë objekt furnizimi i kësaj procedure, sipas skedës teknike që është tjetër dokument bashkëlidhur DT me emërtimin “**Skeda teknike Çela 20kV per N.Stacione**” ku janë paraqitur specifikimet teknike për mallrat e kërkuar si dhe kollona për tu plotësuar nga Operatorët Ekonomik me mallrat e ofertuara. Specifikimet teknike për pajisjet e kërkuara janë hartuar për të përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të detajuar karakteristikat teknike, funksionale të tyre në funksion të nevojave që ka OSSH për instalimin e tyre në N.Stacionet elektrike të Shpërndarjes ekzistues, dhe që janë plotësisht të realizueshme nga të gjithë prodhuesit që kanë përvojë dhe eksperience në prodhimin e tyre.

Këto specifikime kanë domosdoshmeri kryesore për të garantuar që investimi të realizohet në përputhje me standardet kombëtare SSH dhe ato ndërkombëtare IEC, në mënyrë që pajisjet të kenë një jetëgjatësi të lartë dhe siguri në punë nga stafi operator si dhe këto me poshtë:

- siguria e operatorëve dhe e publikut;
- mbrojtja e transformatorëve, kabllave dhe pajisjeve të rrjetit;
- përballimi i defekteve dhe rrymave të shkurtër-lidhjes;
- vazhdimësia e furnizimit me energji;
- pajtueshmëria me rrjetin ekzistues 20 kV;
- standartizimi, mirëmbajtja dhe jetëgjatësia e investimit.

Afati levrimit të pajisjeve 8 (tetë) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues, Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH SH.A, në përputhje me nenin 36 të ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

- Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SHENIM: Per te gjithë standartet ose certifikatat e mesiperme pranohen edhe ekuivalentet e tyre Shqiptare. Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO ose cdo ekuivalent tjetër.

Përfundim: Të gjitha kriteret janë vendosur në mënyrë proporcionale dhe të justifikuara teknikisht e ligjrisht, në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe aktet përkatëse nënligjore, duke garantuar transparencë, konkurrencë dhe realizim cilësor të objektit të prokurimit.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

MINUTES - CONTRACT TYPE - GOODS

ON THE ARGUMENTATION AND APPROVAL OF TECHNICAL SPECIFICATIONS AND QUALIFICATION CRITERIA

